

Formular për SYLLABUS të Lëndës Letërsi e vjetër shqipe

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti Filologjik-Gjuhë Shqipe dhe Letërsi		
Titulli i lëndës:	Letërsi e vjetër shqipe		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	I parë (I)		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	5		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr. Kamber kamberi		
Detajet kontaktuese:	kamberkamberi@hotmail.com		
Përshkrimi i lëndës			
	Lënda <i>Letërsi e vjetër shqipe I</i> përfshin studimin e korpusit letrar shqiptar që nga fillimet e shkrimit shqip (shek. XV) gjer në shek. XVIII. Në kuadër të kësaj lënde trajtohet poetika e letërsisë mesjetare/kishtare dhe humaniste, autorët dhe veprat kryesore të kësaj letërsie.		
Qëllimet e lëndës:	Studimi dhe njohja me kategoritë bazë të poetikës së letërsisë së vjetër shqipe: me konceptet, tiparet letrare, formacionin stilistik-letrar; me veprat dhe autorët më tipikë dhe më të rëndësishëm të kësaj periudhe.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: <ol style="list-style-type: none"> t'i interpretojë tekstet dhe veprat e këtij korpusi letrar; të zhvillojë punë të pavarur analitike dhe studimore; të ballafaqohet me programin e studimeve të mëpastajme; t'i zbatojë njohuritë dhe shkathtësitë e fituara edhe në procesin e mësimdhënies (në shkollën fillore ose të mesme).		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3 (135 min)	15	34
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike	1 (45 min)	15	11
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	2.5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	5	1	5
Detyra të shtëpisë	20 min	15	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30

Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	1	1
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			133,5 orë 133,5:25 = 5,34 5 ECTS
Metodologjia e mësimdhënies:	Kursi organizohet në seri ligjëratash interaktive të përcjella nga diskutimet në klasë për temat që shtjellohen gjatë ligjëratave, punime seminarike për qasjen teorike si dhe prezantime individuale dhe ekipore.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Testi I 20 % Vijimi i ligjëratave 5 % Punimi seminarik 15% Provimi përfundimtar <u>60%</u> Totali: 100 %</p> <p>Vlerësimi në pikë:</p> <p>91-100 10 (dhjetë) 81-90 9 (nëntë) 71-80 8 (tetë) 61-70 7 (shtatë) 51-60 6 (gjashtë) 0-50 5 (pesë)</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<p><i>Historia e letërsisë shqipe I-II, Prishtinë 1971.</i> *** <i>Historia e letërsisë shqiptare, Tiranë 1983.</i> Rexhep Ismajli, Tekste të vjetra, Pejë 2000. Prof. Dr. Mahmud Hysa, Hyrje në letërsinë shqiptare, Prishtinë 2000. Anton Berishaj, Letërsia per-formative, Prishtinë 2010. Robert Elsie, Historia e letërsisë shqiptare, Pejë 2001.</p>		
Literatura shtesë:	<p>Marin Barleti, Historia e Skënderbeut, Tiranë 1967. 2. Marin Barleti, Rrethimi i Shkodrës, Tiranë 1967. 3. Gjon Buzuku, Meshari, Prishtinë 1987. 4. Pjetër Budi, Poezi 1618-1621, Prishtinë 1983 dhe 2006. 5. Frang Bardhi, Fjalor Latinisht-shqip, Prishtinë 1983. 6. Frang Bardhi, Skënderbeu, Shkup 1968. 7. Franciscus Blanchus, Dictionarium latinoepiroticum, Tiran; 2006. 8. Pjetër Bogdani, Çeta e profetëve, Tiranë 2005. 9. F. Sulejmani, E mbsuame e krështerë e Lek Matrëngës, Prishtinë 1979. 10. Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit 1675- 1685, Prishtinë 1982. 11. Sabri Hamiti, Letërsia</p>		

	filobiblike, Prishtinë 2004. 12. Selman Riza, Vepra 4, Prishtinë 2004. 13. Zeqirja Neziri, Poezia e Budit, Shkup 1995. 14. Zeqirja Neziri, Meshari i Buzukut, Shkup 2006. 15. Behar Gjoka, Poetika e Budit, Tiranë 2002. 16. Tonin Çobani, Frang Bardhi dhe relacionet e tij, Zagreb 2006. 17. *** Historia e letërsisë botërore 2, 4, Prishtinë 1986. 18. Prof. Dr. Kolë Ashta, Leksiku historik i gjuhës shqipe, I,III, Shkodër 2000, dhe IV, Shkodër 2002. 19. Prof. Dr. Kolë Ashta, Leksiku historik i gjuhës shqipe II, Tiranë 1998.
--	---

Plani i dizajnuar i mësimi:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Letërsia e vjetër-koncepte, definicione, klasifikime, periodizime
Java e dytë:	Latiniteti mesjetar dhe letërsia humaniste shqiptare – sistemi zhanror dhe konceptcionet poetike
Java e tretë:	Proza humaniste- historia dhe letërsia – vepra e Marin Barletit
Java e katërt:	Proza humaniste – panegjiriku – vepra e Marin Beçikemit
Java e pestë:	Lirika humaniste – vepra e Mikel
Java e gjashtë:	Letërsia religjioze shqipe e shek. XVI-XVII dhe zhanret retorike mesjetare
Java e shtatë:	Doktrina mbi katër kuptimet – pansemioza metafizike, simbolizmi dhe alegorizmi universal
Java e tetë:	Mbikodimi, transtekstualiteti dhe letërsia e vjetër shqipe
Java e nëntë:	Letërsia e vjetër shqipe dhe Bibla
Java e dhjetë:	“Meshari” i Gjon Buzukut
Java e njëmbëdhjetë:	Vepra e Luka Matrangës
Java e dymbëdhjetë:	Vepra e Pjetër Budit
Java e trembëdhjetë:	Vepra e Frang Bardhit
Java e katërmëdhjetë:	“Cuneus prophetarum” – Pjetër Bogdani
Java e pesëmbëdhjetë:	Letërsia e vjetër shqipe dhe baroku religjioz

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore:

- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Të mbajë disiplinën gjatë ligjëratave;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në teste dhe provim;

Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t’i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.

